



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 29.01.2021

Prot.29 (njëzetëenëntë)

Protokoll nr. 29

I mabajtur sot më datë 29.01.2021, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00. (online)

Me këtë rend dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi,vendimet e mbledhjes së kaluar,miratimi i rendit të ditës);
2. Miratimi i Mandatit të Këshilltarit dhe betimi i znj.Vasilika Stiljan Trajko.
3. P-V “Për miratimin e kritereve, proceduarve, dokumentacionit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në masën 6% të fondit”;
4. P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2020”;
5. P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;
6. P-V “Për miratimin e bursave shtesë të arsimit të mesëm profesional, viti shkollor 2020-2021”;
7. P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 99, datë 24.12.2020 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës (qendër) dhe strukturave të tjera”;
8. P-V “Për dhënen me qira të një sipërfaqeje pranë ish-Kombinatit të Sheqerit sh.a Maliq”
9. P-V “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2022-2024”
10. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave drejtuar Këshillit Bashkiak Maliq.
11. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

**Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Floreta Zaçe; File Qyrani; Fevri Sherfi (laragohet pas konfirmimit të korumit); Vasilika Trajko 6 (gjashtë) këshilltarë.**

**Këshilltarë online në platomën ZOOM: Fatjon Braimlli; Valentina Pashollari; Idlir Limlli; Kristina Malelli; Kristiana Jonuslli; Rexhina Hëna; Jonilda Koçllari; Enida Avdolli; Erinda Hamzaj; Armando Dautlli; Gentiana Drabo; Dorjan Zholanji; Aleksandër Petriti; Aldi Mullalli; Ilia Xhuti; Xhesika Selko; Klement Zere 17(shtatëmbëdhjetë) këshilltarë.**

**Të pranishëm nga Administrata: Nën/Kryetari: Eridion Rustemi; Dr.Burimeve Njerëzore Genci Floqi; Dr. i Shërbimit Social Azem Nuhu; Përgjegjse Sektori Dr e të Ardhurave Alma Shkëlqimi**

**1.O.Demollari:** Fillon mbledhjen e këshillit sipas rendit të ditës, të gjithë jeni njohur me rendin e ditës dhe materialet shoqëruese, ka diçka për rendin e ditës, e miratojmë? Hidhet në votim miratohet rendi i ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**O.Demollari:** Lexon vendimet e mbledhjes së datës 24.12.2020, vendime të cilat kanë marrë dhe konfirmimin ligjor nga Prefektura.

2. Miratimi i Mandatit të Këshilltarit dhe betimi i znj.Vasilka Stiljan Trajko.

**O.Demollari:** Fjalën e ka Komsioni i Mandateve, më pas kalojmë te betimi i Këshilltares.

**P.Begolli:** Si kryetarre e Komsionit të Manadateve lexon Raportin e përgatitur.

**O.Demollari:** Lexon formulën e betimit.

**Vasilika Trajko:** Beto hem

**P.Begolli:** Si kryetarre e Komsionit të Manadateve hedh në votim mandatin e këshilltares Vasilka Trajko, hidhet në votim, miratohet, 5 anëtarë votojnë me karton në sallë, 17 online.

**Këshilli:** I uron suksese këshilltares së re.

**O.Demollari:** Njofton këshillitarët, pas mbledhjes së këshillit kemi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sh.a Klubi Futbolli Maliq.Vazhdojmë me rendin e ditës.

3.P-V “Për miratimin e kriterave, proceduarve, dokumentacionit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në masën 6% të fondit”;

**O.Demollari:** Lexon P-V e paraqitur në Këshill, kush e do fjalën?

**V.Pashollari:** Kërkon fjalën, te kriteret që janë përcaktuar të janë prioritet pleqtë e vetmuar dhe i propozon një emër Dr. së Shërbimit Social në fshatin Sovjan, Hekuran Hyska.

**Azem Nuhu:** Jep përgjigje për shqetësimin e znj.Valentina, kriteret i miratojmë çdo fillim viti, sipas ligjeve në fuqi, kjo kategori është e përfshirë te kriteret.

**O.Demollari:** Ka pyetje të tjera? E kalojmë në votim, hidhet në votim, miratohet, 5 anëtarë votojnë me karton në sallë, 17 online.

**O.Demollari:** Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

4.P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2020”;

**O.Demollari** Kush e do fjalën? E kalojmë në votim, hidhet në votim, miratohet, 5 anëtarë votojnë me karton në sallë, 17 online.

**O.Demollari:** Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

5.P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;

**O.Demollari:** Kush e do fjalën?

**P.Begolli:** Sqarimiet e nevojshme janë pasqyruar në relacion, por pse ka diferanca te shuma?

**Azem Nuhu:** Jep përgjigje për shqetësimin e znj.Pranvera, kërkesa me karakter financier ka shumë që na drejtohen, janë përzgjedhur ato familje që kanë më shumë probleme, te familjet që ndihma është propozuar 10.000 lekë, kjo shumë është kërkuar nga vetë familjarët për problemet që ata kishin, prsh. për familjen e z.Edison Agushi dhe Përparim Meçaj do kryejnë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

një ndëryhje kirurgjikale që kushton sa shuma e përcaktuar , ndërsa pjesa tjetër ka probleme të tjera shëndetësore me diagnoza më të rënda si (tumore, ndërhyrje të tjera, etj). Kërkesat janë shumë dhe ne nuk i përballojmë dot të gjitha.

**O.Demollari:** Ka pyetje të tjera?

**V.Pashollari:** Kërkon fjalën! Drejtori dha shpjegimet por te familja e z.Edison Agushi që përbëhet nga 5 anëtarë, dhe që bashkëshortja ka masë tumorale dhe te familja e z.Përparim Meço, familje me 7 anëtarë, nuk besoj se këto familje kanë më pak nevojë se familjet e tjera, nuk është njëlloj familja që nuk çon dot fëmijën në shkollë me rastin e familjes që pjestari me masë tumorale, kështu këshilli duhet të miratojë disa kritere që shuma të mos jetë preferenciale.

**Azem Nuhu:** Jep përgjigje për shqetësimin e znj.Valentina, kërkesa që ka bërë familja e z.Edison Agushi, kërkonte atë shumë për të përballaur vetëm analizat mjekësore dhe analziat kaq kushtonin 10.000 lekë, ne kaq kishim mundësi ta ndihmonim deri në këtë moment, për familjen e z.Server, kërkesën e ka bërë vetë vajza ku thoshte që nuk vazhdonte dot shkollën dhe u mendua kjo shumë pasi vajza është në vit të fundit dhe nuk mund ta linim ta braktiste shkollën dhe u gjykua të vendosej kjo masë. Shkolla nuk shkon 30.000 lekë se ka shumë shpenzime, pjesën tjetër ta potësojë vetë familja që mos e ndërpresë shkollën në vitin e fundit, por ta vazhdojë si gjithë tjerët.

**V.Pashollari:** Si kjo familje për nevojë shkolle mund të ketë shumë, por unë them që të vendosim disa kritere, që masa mos mbetet në dorën e Drejorit të Shërbimit Social apo dikujt tjetër .

**Azem Nuhu:** Shifrat nuk janë vendosur nga unë, rasti i kësaj familje është vërtet specifik në dallim nga familjet e tjera që kanë fëmijë në shkollë, për rastin e kësaj familjeje kemi biseduar më parë me punonjësin social të NJA dhe Dr. e Financës dhe Buxhetit për shumën.

**O.Demollari:**Fjalën e ka Nën/Kryetari i Bashkisë z.Eridjon Rustemi.

**Eridjon Rustemi:** Kjo familje nuk trajtohet me ndihmë ekonomike kështu e pamë të arsyshme të vendosnim një vlerë për të mundësuar shkollimin e vajzës pasi është familje në vështirësi ekonomike, e njoh dhe personalisht pasi jeton në Pojan.

**Azem Nuhu:** Po e ndihmojmë deri sa të bëhet përsëri pjesë e skemës së ndihmës ekonomike. Kur je pjesë e ndihmës ekonomike përjeshtohesh dhe nga pagesa e shkollës.

**V.Pashollari:** Si këshilltare kam eksperiencë se kam 3 mandate, kështu që jam marrë dhe me ndihmat financiare dhe për mos bërë qoka, këshilli të vendosë disa kritere.

**O.Demollari:** Po Vali e qartë, ka pyetje të tjera? E kalojmë në votim, hidhet në votim, miratohet, 5 anëtarë votojnë me karton në sallë, 17 online. Faleminderit!

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

6.P-V“Për miratimin e bursave shtesë të arsimit të mesëm profesional viti shkollor 2020-2021”;

**O.Demollari:** Kush e do fjalën?



REPUBLIKA E SHQIPĒRISË

**P.Begolli:** Këto janë shtesa dhe për ne sa më shumë emra të ketë më mirë, them ta kalojmë P-V,

**O.Demollari:** Po këto janë shtesa. Kush e do fjalën? E kalojmë në votim, hidhet në votim, miratohet, 5 anëtarë votojnë me karton në sallë, 17 online. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

7.P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.99, datë 24.12.2020 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës (qendër) dhe strukturave të tjera”;

**O.Demollari:** Kush e do fjalën?

**P.Begolli:** Herën e kaluar ne miratuam buxhetin, ne si Këshill bëmë disa propozime, për pozicionin marangoz që është propozuar për ndryshim page nuk kemi çfarë të themi, por kam propozuar të bëhet ndryshim page për pozicionin marangoz-xhamaxhi, paga e tij është 30.000 lekë sa ajo e një punëtori të thjeshtë, duke ditur ngarkesën e tij ka në ngarkim gjithë shkollat e bashkisë, kemi kërkuar një rritje page, jam dakord me shtesën që i bëhet pozicionit të Drejorit të Pyje Kullotave, por kam kërkuar në emër të Këshillit që paga e pozicionit të Drejorit në bashki të jetë njehësuar, sidomos ata që kanë ngarkesë pune, si psh. paga e Drejorit të Shërbimit Social është 55.000 lekë, të shkojë 60.000 lekë dhe paga e Sekretarit të Këshillit të kishte një ndryshim, kemi propozuar që buxheti të miratohej me ndyshimet e propozuara.

**O.Demollari:** Lexon P-V e paraqitur në Këshill dhe propozimet që bëri znj. Pranvera Begolli do mbeten për një mbeldhje tjetër. Ka pyetje të tjera?

**F.Qyrani:** Dhe unë jam dakord me propozimin e znj. Verës, por te Drejoria e Pyje Kullotave duke marrë parasysh ngarkesën e punës dhe bashkitë e tjera shikoj që paga e specialistëve të mesëm apo të lartë është e ulët, jemi nën mesataren e bashkive të tjera, një specialist me pagë 36.000-38.000 lekë nuk e shikoj të arsyeshme!

**O.Demollari:** Po File e qartë, ka pyetje të tjera? E kalojmë në votim, hidhet në votim, miratohet, 5 anëtarë votojnë me karton në sallë, 17 online. Faleminderit! Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

8. P-V “Për dhënien me qira të një sipërsfaqeje pranë ish-Kombinatit të Sheqerit sh.a Maliq”

**P.Begolli:** Në cilësinë e Administratores së Kombinatit të Sheqerit Sh.a Maliq, janë disa detaje shtesë për P-V e paraqitur, Bashkia Maliq ka kërkaur që ish-fabrika e Niseshtesë të përdoret si magazinë, kërkesa bëhet në bazë të udhëzimit që përcakton kriteret të veçanta për dhënie me qira, janë mbyllur të gjitha dokumentacionet e nevojshme, është marrë vendim në Këshillin Mbikëqyrës, janë bërë gent-planet, certifikatat besoj se i keni bashkëngjitur?

**O.Demollari:** Kemi bashkëngjitur dhe cerifikatën e pronësisë dhe vendimin e Këshillit Mbikëqyrës.

**P.Begolli:** Ky ambient do i vijë në ndihmë Bashkisë Maliq për nevojat e saj.

**O.Demollari:** Pra është ish-Niseshtesa?

**P.Begolli:** Po është ish-fabrika e Niseshtesë.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**O.Demollari:** Ka pyetje ose paqartësi, e do dikush fjalën? E kalojmë në votim, hidhet në votim, miratohet, 5 anëtarë votojnë me karton në sallë, 17 online. Faleminderit!

**O.Demollari:** Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

9. P-V “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2022-2024”

**O.Demollari:** Lexon P-V e paraqitur në Këshill. Kush e do fjalën?

**P.Begolli:** Jemi përsëri te pjesa e financës, ato janë parashikime që detyrimisht do diskutohen te buxheti që do na paraqitet, unë them t'i kalojmë për miratim, por do desha, e di që do ma marrin si personale, por fjalën e kam te subvencionohen dhe ato sh.a që janë pjesë e Bashkisë Maliq për detyrimet që kanë, pra të ketë më shumë parashikim.

**O.Demollari:** Mund të japë një shpjegim dhe znj.Alma Shkëlqimi për parashikimet e vitit 2021 që duket ambicioz dhe nga ana tjetër atje te shpjegimi juaj thuhet që ka familje që janë në bashki dhe nuk janë rezidentë këtu, dua të them që vjelja e këtyre të ardhurave nuk realizohet duke mos qenë nga ana tjetër, ju keni bërë një parashikim shumë ambicioz dhe uroj që të realizohet, si keni menduar ju si drejtori?

**Alma Shkëlqimi:** Ky parashikim që ne kemi parqitur është bazuar në ligjin nr.68 për finansat publike dhe është një detyrim ligjor që pasyon të ardhurat e dy viteve më parë, të vitit faktik që jemi (2021) dhe të ardhurat për tre vitet pasardhëse. Ne kemi parashikuar 300 mijë lekë ardhura, vërtet ky parashikim është ambicioz por kemi disa probleme, parashikimi i zërit Tokë, që është një zë me shumë peshë dhe zëri Ndërtesë. Ky parashikim bëhet për të gjithë qytetarët pavarësisht se ata janë ose jo rezidentë sepse është një pasuri që ata e disponojnë dhe nuk është thënë dhe nuk është e mundur që vjelja e këtyre të ardhurave të bëhet brenda viti koherent. Ata mund të janë emigrantë ose jetojnë brenda territorit të Shqipërisë, ka të tjerë që kanë tërhequr dokumentat dhe kjo bën të vështirë për t'i gjetur dhe t'i mbledhur detyrimin, sidomos për emigrantët, por kjo e ardhur duhet të parashikohet se do vijë koha që do mblidhet, e njëjtë gjë është dhe për ndërtesat, ka ndërtesa që janë por nuk banon njeri por zëri i Tokës është më shumë problem, ndërsa për të Tarifat ardhurat nga si e kam shpeguar dhe në material nuk është marrë numri total i familjeve, por numri i familjeve që mund të janë rezident që përsëri të le vend për diskutim dhe ne kemi marrë parametrat që përdor Qeveria që bën transfertën e pakushtëzuar duke marrë parasysh censusin e popullsisë.

**O.Demollari:** Po ka një shpjegim për këtë.

**Alma Shkëlqimi:** Po ka një shpjegim për këto të dhëna në material, një zë tjetër që ka peshë te të ardhurat janë drutë e zjarrit, ka disa probleme që nuk varen nga ne, por ne shpresojmë që çdo vit ajo të realizohet dhe t'i jepet drejtim këtyre problemve ligjore, kështu parashikimi dhe për vitin 2021 dhe në tre vitet në vazhdim është në të njëjat nivele sepse ndikon edhe numri i debitorëve, se kemi numër të lartë të debitorëve dhe në dy zërat që përmenda më sipër.

**O.Demollari:** Po e keni shpeguar dhe këtë.

**Alma Shkëlqimi:** Këto janë tre pikat që kanë riskun më të madh dhe ndikojnë në realizimin e të ardhurave.

**P.Begolli:** Alma po të pyes diçka? Investimet që kryhen nga Ujësjellësi, kryhen nga vetë bashkia apo sh.a Ujësjellësi Maliq?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Alma Shkëlqimi:** Ky është parashikimi i të ardhurave që ne realizojmë, nuk ka lidhje me ujësjellësin, janë të ardhura vendore ku përfshihen të ardhura nga Taksa dhe Tarfiat vendore.

**O.Demollari:** Ka pyetje të tjera? Duke uruar që plani të realizohet, e kalojmë në votim, hidhet në votim, miratohet, 5 anëtarë votojnë me karton në sallë, 17 online. Faleminderit! Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

10.Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave drejtuar Këshillit Bashkiak Maliq.

**P.Begolli:** I nderuar Kryetar para se të fillojmë me shqyrtimi e tyre, mund të bëj dhe unë një kërkesë?

**O.Demollari:** Po Vera.

**P.Begolli:** Aktualisht në qytetin e Malit të Qendror është shumë problematike ujësjellësi prandaj po e ngre dhe këtë shqetësim, n.q.s. e keni vënë re në kohë me shi uji i pijshëm ndotet shumë, i propozoj Bashkisë Malit si aksioner i vetëm sh.a-së, Ujësjellësi të gjejë një zgjidhje të invesoheret, se kjo është e rrezikshme për jetën e qytetarëve por dhe për pajisjet shtëpiake, nuk punojnë mirë se mbushen me baltë nga uji, kështu në mungesë të Kryetarit të Bashkisë, Nën/Kryetari t'ja përcjellë këtë shqetësim dhe në mbledhjen e radhës në një pikë të rendit të ditës që drejori të jetë prezent me një informacion për punë ne kryer nga Ujësjellësi sh.a Maliq.

**O.Demollari:** Qyetarët e kanë hasur këtë problem në ditët që kaluan, Nën/Kryetar në mbledhjen e radhës përfaqësues të ujësjellësit të jenë prezent me një informacion.

**Genci Floqi:** Sqaron se nga dita e mërkurë ka filluar një projekt për stabilizimin e kësaj gjendje dhe rregullimin e rrjetit, ditë e mërkurë kanë qenë prezent inxhinierët.

**P.Begolli:** Në mbledhje e këshillit thirren të gjithë për të raportuar!

**F.Qyrani:** Ata mund të vijnë me rezultatet e këtij muaji pasi është zgjidhur problemi.

**O.Demollari:** Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave drejtuar Këshillit Bashkiak Maliq.

Lexon kërkesat drejtuar këshillit, janë 4, kërkesa e parë ka të bëjë me anullimin e emërimit të një rrugës në NJA Libonik nga "Shaban Hoxha" në "Feim Zboqi", kjo kërkesë është bërë nga shoqata Gora e Bashkuar, me sili në Elbasan.

**P.Begolli:** E kam parë kërkesën dhe shumë mirë që bëhet por nuk kuptoj arsyen pse duhet të heqim një emër dhe të vemë një emër tjetër, shpjegohet që Feim Zboqi ka dhënë kontribut për Zboqerinë, luftën etj, po nuk na shpjegon arsyen pse duhet të hiqet emri i Shaban Hoxhës, se ajo rrugë tashmë e ka një emër, nëse do ishte pa emër edhe mund t'i vihej një emër por në këto kushte kur ka një emër pa justifikuar arsyen pse të hiqet ky emër?

**F.Qyrani:** Dhe unë me këtë mendim bashkohem kur ka rrugë të re mund t'i vemë një emër, po të heqim një emër dhe të vemë një emër nuk jam dakord, sepse ngjall pakënaqësi te ai që e heqim, duhet të këtë një arsy që po e heq.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**O.Demollari:** Grupi që ka dërguar këtë kërkesë i lutemi të sjellë një informacion shtesë për arsyen që duhet të hiqet rrugës emri i parë!

**V.Pashollari:** Do kërkoja që këto kërkesa të kalojnë nga Drejtoria e Kulturës dhe të vijë me propozim nga drejoria nësë është për t'u futur në Këshill.

**O.Demollari:** Dakord! Lexon ankesën tjetër drejtuar këshillit, që ka ka të bëjë me një grup qytetarësh të fshatit Vloçisht, NJA Libonik që nuk ju ofrohet shërbimi i ndriçimit publik afër banesave të tyre, kërkojnë të përjashtohen nga tarifa e ndriçimit.

**P.Begolli:** Kjo është kompetencë e bashkisë, t'i kalojë sektorit përkatës, Drejtorisë së Shërbimeve ose Urbanistikës.

**O.Demollari:** Duhet dhënë një shpjegim për këtë edhe nëse nuk ke ndriçim te rruga jote apo tek shtëpia jote, kjo familje përfiton nga ndriçimi që është te rruga tjetër apo në qendër të fshatit, dakord jemi që çdo rrugë të ketë ndriçim po kohë pas kohe.

Çfarë mendimi keni?

**F.Qyrani:** Nëse bëhet fjalë për një grup familjesh jam dakord me shqetësimin, duhet çuar ndriçimi, ne kemi fakte që kemi shpënë ndriçim dhe për një familje.

**O.Demollari:** Kërkesa do i kalojë Drejtorisë së Shërbimeve, Nën/Kryetar ke diçka?

**Eridion Rustemi:** Jam në djeni të problemit, kjo lagje është në distancë shumë largët nga fshati ndodhet në rrugën kryesore të Vloçishtit, familjet kërkojnë të përjashtohen nga tarifa e ndriçimit deri sa bashkia t'ja u ofrojë këtë shërbim, kjo lagje është në prioritet e bashkisë për t'u kompletuar me ndriçim, por ka një kosto raport me pjesën tjetër të fshatit.

**F.Qyrani:** Prioriteti me zbatimin janë gjëra të kundërtta, kur të ofrohet shërbimi të paguhet dhe ndriçimi, të njëjtin shqetësim kam edhe për një lagje në Fshat Maliq, Fshat Maliqi është model, ndërsa kjo lagje nuk ka as pastrim, as ndriçim, fshatit Goçë i hiqet tarifa e ndriçimit, ne nuk na hiqet si lagje, kur ta kem shërbimin duhet të paguaj, këto raste duhen parë. Fshati Goçë është hequr nga tarifat.

**O.Demollari:** Nën/Kryetar mbaje shënim shqetësimin, kërkesa do i kalojë Drejtorisë së të Ardhurave.

Lexon kërkesën tjetër, dërguar nga Shoqata Besëlidhja Gorare, me lendë: "Kërkesë për vendosjen e një memoriali në qendër të Maliqit".

**P.Begolli:** Nuk e di çfarë do thonë kolegët, jep një përshkrim për kontributin e tyre dhe ne jemi dakord me to, por ky memorial të vendoset në qendër të Gorës, jo në Maliq. Qyteti i Maliqit ka personalitet e tij që kur është krijuar dhe për ata mund të ketë memoriale. Kjo kërkesë do i delegohet administratorit të NJA Gorë.

**O.Demollari:** Ka sygjerim tjetër?

Kemi dhe një kërkesë tjetër nga NJA Moglicë edhe kjo kërkesë ka të bëjë me vendosjen e disa emrave të shkollave:

- Shkolla 9-vjeçare, Zerec "Shaban Zereci";
- Shkolla 9-vjeçare, Popçisht "Shahin Matraku";



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Vendosja në qendër të fshati Moglicë të bustit të Hasan Moglicës.

**P.Begolli:** Nëse këto shkolla kanë qënë pa emra jemi dakord t'u vendoset, nëse kanë emra ta shpjegojnë arsyen pse hiqen këto emra.

**O.Demollari:** Duhet të kemi parasysh se për këto raste duhet të bëjmë konstultim paraprak.

**P.Begolli:** Për këto raste duhet të merret Drejtoria e Kulturës sepse ajo i mbulon këto, por kjo është firmosur nga vetë administratori.

**O.Demollari:** Po është firmosur nga administratori.

**P.Begolli:** Të shikohet, besoj se është marrë vendim kolegjal dhe ka dhe relacion shpjegues dhe shkollat kanë qenë pa emra dhe ka dakortësi të komunitetit për këto emra që mos krijojmë probleme, jemi dakord.

**O.Demollari:** Bazuar në rregulloren e Këshillit Bashkiak mbi të cilën ne operojmë përvendosjen e një emri në rastet kur nuk ka duhet t'i drejtoshemi një konsultimi publik dhe unë parmisht jam dakord përvendosjen e kërtyle emrave, por pasi të kemi marrë dhe opinioni e komunitetit vendas.

Ka ndonjë mendim tjetër nga kolegët online? Parmisht jemi dakord.

**P.Begolli:** Jo dakord, parmisht për të gjitha rastet vetëm përkërkeshat e Moglicës.

**O.Demollari:** Jo vetëm për Moglicën dhe në ato raste kur këto objekte nuk kanë emra.

**P.Begolli:** Dhe komuniteti është i përfshirë në këto propozime.

**Eridion Rustemi:** Kur ka një emër nuk e ndryshon dot, kur ky emër është i përshtshëm, kur emri është i papërshtshëm me termat e gjuhës shqipe mund ta ndryshosh.

**P.Begolli:** Kur ka emra të huaj.

**Eridion Rustemi:** Kam fjalën për emra dhe mbimera të papërshtshëm që mund të ndikojnë negativisht në zonë mund t'i hiqet ai emër kur ka probleme mund ta ndryshosh.

**F.Qyrani:** Dhe emri që është vënë ka një vendim, s'ka patur dakortësi 100% por ka një vendim, dhe ne ashtu do veprojmë, prandaj duhet një shpejgim për emrin që është vënë.

**Eridion Rustemi:** Këto raste bëhen me dëgjesa publike.

**F.Qyrani:** Ne nuk duam ta lemë pa emër as shkollën, as rrugën por ju për ndryshime se do vijë koha pas një periudhe do kërkohet përsëri të ndyshohet.

**Eridion Rustemi:** Këshilli ka të drejtë për rastet kur ka ndryshime emri dhe duhen parë me kujdes.

**P.Begolli:** Pa dëgjesa publike nuk i bëjmë dot.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**O.Demollari:** Kërkesa do shikohet me detaje, sepse kërkesa ka adhur sot dhe nuk është parë deri në fund bashkë me relacionin, nëse nuk ka emër dhe pasi të kemi bërë konsultime publike do marrim vendim për t'i vendosur emrat, nëse kanë emër pastaj do shohim nëse ai emër ka këto probleme që tha Nën/Kryetari, nëse nuk i ka, është vështirë të ndryshojë.

**P.Begolli:** Për vodosjen e bustit në Moglicë duhet të bëhet dëgjesa publike, që mos kemi probleme me komunitetin dhe që me të drejtë mund të thotë pse e vodosët këtë bust në fshat pa dakortësinë tonë.

**O.Demollari:** Dakord! Për të marrë një vendim duhet konsultim me publikun.

**Eridion Rustemi:** Bashkia Maliq ka një eksperiencë të freskët për këto raste, vodosja e emrit të stadiumit të Pojanit ku u zhvillua një dëgjesë publike, bashkë me dokumentacion u soll dhe historiku i jetës së të ndjerit që ju vodos emri stadiumit, ishte një dokumetacion voluminoz që u përgatit.

**O.Demollari:** Dakord! Kjo ishte mbledhja e këshillit për ditën e sotme.

Mbledhja mbyllet!

Faleminderit!

## KRYETARI I KËSHILLIT

**Ornildi DEMOLLARI**

---